



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ .2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[24.05.2021]

Për: Operatorin ekonomik “AL-ASFALT” shpk

**Adresa: Durres Xhafzotaj, Sallmone Rruga Hoxheve,
Zona kadastrale 3852, Nr. pasurie 19/36**

Procedura e prokurimit: Pune/Procedure e Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-89963-03-12-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakës”

Fondi limit: 124.503.327,1 (njqind e njezet e kater milion e peseqind e tre mije e treqind e njezet e shtate presje nje) lekë pa TVSH

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve 23.09.2019 [Nr.38]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “BOE “S.M.O UNION” shpk & “LIQENI VII” sh.a

NUIS: J66902042Q / K01730502W

Vlera: 83.872.604 (tetedhete e tre milion e teteqind e shtatedhete e dy mije e gjashteqind e kater) leke pa tvsh

2. BOE “Sterkaj” shpk & “KUPA” shpk

NUIS: J68310708M / K51615512C

Vlera: 101.824.118 (njqind e nje milion e teteqind e njezet e kater mije e njqind e tetembedhjete) leke pa tvsh

3. BOE “NIKA” SHPK & “PEPA” SHPK

NUIS: J76705047U / L42215009L

Vlera: 75.814.583,25 (shtatedhjete e pese milion e teteqind e katermbedhjete mije e peseqind e e tetedhjete e tre presje njezet e pese) lekë pa tvsh.

4. “AL-ASFALT” sh.p.k

NUIS: K81511508A

Vlera: 121.508.153 (njqind e njezet e nje milion e peseqind e tete mije e njqind e pesedhjete e tre) lekë pa tvsh

5. “K-AAV” Sh.p.k

NUIS: L51506025C

Vlera: 94.425.733,5 (nentedhjete e kater milion e katerqind e njezet e pese mije e shtateqind e tridhjet e tre presje pese) lekë pa tvsh.

6. JV “Company Riviera 2008” shpk & “Agri Construction” shpk

NUIS: K81716011V / K01725001F

Vlera: 110.808.771 (njqind e dhjete milion e teteqind e tete mije e shtateqind e shtatedhjete e nje) lekë pa tvsh.

7. “VELLEZERIT HYSA” shpk

NUIS: K12911201C

Vlera: 97.127.149 (nentedhjete e shtate milion e njqind e njezet e shtate mije e njqind e dyzet e nente) lekë pa tvsh.

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. “BOE “S.M.O UNION” shpk & “LIQENI VII” sh.a

NUIS: J66902042Q / K01730502W

2. BOE “Sterkaj” shpk & “KUPA” shpk

NUIS: J68310708M / K51615512C

3. BOE “NIKA” SHPK & “PEPA” SHPK

NUIS: J76705047U / L42215009L

4. “K-AAV” Sh.p.k

NUIS: L51506025C

5. JV “Company Riviera 2008” shpk & “Agri Construction” shpk

NUIS: K81716011V / K01725001F

6. “VELLEZERIT HYSA” shpk

NUIS: K12911201C

1. Skualifikohet Bashkimi i Operatoreve ekonomike “STERKAJ & KUPA”, sepse nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kriterëve te kerkuara ne DT dhe bazez ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP. Konkretisht, në licencën profesionale të shoqërisë STERKAJ shpk, me NZ.1354/19, date 27.11.2018, rezulton që në listën e drejtuesve teknik të saj të jetë edhe Elida Milo (Dizdari). Nga te dhenat e formularit E - SIG “Listpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi”, si dhe lista e punëtorëve për periudhën e kërkuar e lëshuar nga administrata tatimore e të paraqitur nga subjekti për periudhën Gusht 2020 – Janar 2021, rezulton qe nuk janë derdhur sigurimet shoqërore, kjo në kundërshtim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, te DST-se, ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve sipas legjislacionit në fuqi. Po keshtu, kjo bie ne kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtime, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c ku percaktohet se Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë. Dhe ne vijim Kreu VII ku percaktohet se Shoqërise qe kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.

Gjithashtu, bashkimi i operatoreve ekonomike nuk ploteson kriterin ne piken 2.3.15 të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave të tenderit për mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, pasi për mjetet e mëposhtme rezulton:

1-Mungon Autofshese – Paraqitet vetëm një deklaratë doganore e pashoqëruar me dokumentacionin shtesë sikurse është a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor); b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; d) Licencë transporti e) Certifikate transporti nga njësia vendore dhe foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij, nuk përmbushin kërkesat e DST

2- Mungon Freze gjërryese me gjerësi 2m (makineria e paraqitur është minieskavator)

3-Mungon Trencher për hapje kanali 25-30 cm (makineria e paraqitur është minieskavator)

4-Mungon Auto mjet për vijezim me boje termoplastike me kapacitet jo më pak se 4.5 ton. Mjeti i paraqitur nuk është Automjet dhe jo në tonazhin e kërkuar.

2. Skualifikohet Bashkimi i Operatoreve ekonomike “NIKA & PEPA GROUP”, sepse nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DT dhe bazës ligjore në fuqi të aplikueshme sipas rregullave të prokurimit dhe LPP. Konkretisht operatori ekonomik “**PEPA GROUP**” referuar kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë gjithë punimet e sinjalistikës rrugore sipas preventivit të punimeve mirëpo sipas deklaratës mbi disponimin e makinerive dhe dokumentacionit për këtë qëllim operatori PEPA GROUP nuk ka deklaruar dhe nuk dëshmon se disponon makineritë dhe pajisjet për të realizuar këto lloj punimesh. Kjo bie në kundërshtim me nenin 74, pika 3 të VKM 914 në të cilën kërkohet: *...Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. [].* Mjetet Batipal dhe makinë vijëzimi të paraqitura nga operatori tjetër nuk janë në përputhje me dokumentet e tenderit.

Gjithashtu bashkimi i operatoreve ekonomike nuk ploteson kriterin ne piken 2.3.15 të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave të tenderit për mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës pasi për mjetet e mëposhtme rezulton:

1-Mungon Trencher për hapje kanali 25-30 cm (makineria e paraqitur është mjet bujqësor për mbjellje fidanësh);

2-Mjetet e marra me qera Autobot uji me targë AA301VR, SH4498E, kamiona me targë AA328HZ, KO4982B, AB954AM, Autobitumatriçe me targë KO3347B, AA230UL janë të shoqëruara me Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë qeradhënësve. Në këtë

mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë qeramarrëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport, i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

3. Skualifikohet Bashkimi i Operatoreve ekonomike “SMO UNION & LIQENI VII”, sepse nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DT dhe bazës ligjore në fuqi të aplikueshme sipas rregullave të prokurimit dhe LPP. Konkretisht në licencën profesionale të shoqërisë SMO UNION shpk, me NZ.1868/20, date 26.12.2019, rezulton që në listën e drejtuesve teknik të saj të jetë edhe Inxh. Adem Vucini. Nga të dhënat e formularit E - SIG “Listepagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, si dhe lista e punëtorëve për periudhën e kërkuar e lëshuar nga administrata tatimore e të paraqitur nga subjekti për periudhën Gusht 2020 – Janar 2021, rezulton që nuk janë derdhur sigurimet shoqërore nga muaji dhjetor 2020 dhe në vazhdim çka tregon se ai i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me shoqërinë "SMO UNION" sh.p.k, kjo në kundërshtim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, të DST-se, ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve sipas legjislacionit në fuqi.

Po kështu, kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c ku përcaktohet se Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë. Dhe në vijim Kreu VII ku përcaktohet se Shoqërisë që kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.

Gjithashtu, bashkimi i operatoreve ekonomike nuk plotëson kriterin në pikën 2.3.15 të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave të tenderit për mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës pasi për mjetet e mëposhtme rezultojnë:

1-Mungon Autofshese – Paraqitet vetëm një faturë e thjeshtë tatimore e pashoqëruar me dokumentacionin shtesë sikurse është a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor); b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; d) Licencë transporti e) Certifikate transporti nga njësi vendore dhe foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij, nuk përmbushin kërkesat e DST

2- Mungon Freze gjeryese me gjerësi 2m (makineria e paraqitur është minieskavator)

3- Mungon Auto mjet per vijezim me boje termoplastike me kapacitet jo me pak se 4.5 ton. Mjeti i paraqitur eshte cilësuar për bojë bikomponente dhe jo ne tonazhin e kerkuar.

4- Mjetet e marra me qera kamiona me targë SH5139D, SH5109D janë të shoqëruara me Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë qeradhënësve. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë qeramarrëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

4. Skualifikohet Bashkimi i Operatoreve ekonomike “COMPANY RIVIERA & AGRI CONSTRUCTION”, sepse nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kriterëve te kerkuara ne DT dhe bazez ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP. Konkretisht, operatori ekonomik “AGRI CONSTRUCTION” shpk referuar kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë gjithë punimet e sinjalistikës rrugore sipas kapitullit D të preventivit të punimeve, mirëpo sipas deklaratës mbi disponimin e makinerive dhe dokumentacionit për këtë qëllim operatori “AGRI CONSTRUCTION” nuk ka deklaruar dhe nuk dëshmon se disponon makineritë dhe pajisjet për të realizuar këto lloj punimesh. Kjo bie në kundërshtim me nenin 74, pika 3 të VKM 914 në të cilën kërkohet: *...Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. [].* Mjetet Batipal dhe makinë vijëzimi të paraqitura nga operatori tjetër nuk janë në përputhje me dokumentet e tenderit pasi janë të pashoqëruara me dokumentacionin shoqërues.

Gjithashtu, bashkimi i operatoreve ekonomike nuk ploteson kriterin në pikën 2.3.15 të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave të tenderit për mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës pasi për mjetet e mëposhtme rezulton:

1-Mungon Trencher per hapje kanali 25-30 cm (makineria e paraqitur eshte bobcat);

2-Mungon një mjet eskavator me goma, sepse mjeti i paraqitur si i tillë është fadromë.

5. Skualifikohet operatori ekonomik “VËLLEZËRIT HYSA”, sepse nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kriterëve te kerkuara ne DT dhe bazez ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP. Konkretisht, operatori ekonomik “VËLLEZËRIT HYSA”, nuk ploteson në pikën 2.3.15 të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave të tenderit për mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës pasi për mjetet e mëposhtme rezulton:

1-Mjetet e mara me qera, kamiona me targë AA987IV, AA114VL janë të shoqëruara me Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë qeradhënësve dhe janë të skaduara në datën 06.04.2021. Edhe mjeti tjetër i marrë me qera, kamion me targë AA610ST është i

shoqëruar me Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë qeradhënësit. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë qeramarrëse do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport, i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

2- Mjetet e marra me qera, Autobetoniere kantieri me targë AA906XJ, fadromë me goma me targë AA077XE, kamion me targë AA987IV janë me siguracion (polica e sigurimit) të pavlefshëm.

3- Mungon pajisja Trencher për hapje kanali 25-30cm – Paraqitet kontratë qeraje jo para noterit publik, shoqëruar vetëm me një faturë tatimore. Kjo është në kundërshtim në DT në të cilat kërkohet: [] *Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes /kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerase, faturat tatimore të shitjes / kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.* []

4- Mungon Automjet për vijezim me bojë termoplastike me kapacitet jo më pak se 4.5 ton. Mjeti i paraqitur me faturë tatimore është i pashoqëruar me dokumentacionin e origjinës (deklaratë doganore/kontratë shitje) dhe është për bojë bikomponente dhe jo në tonazhin e kërkuar.

5- Mungojnë mjetet dhe pajisjet semafor për menaxhim trafiku, trencher, makineri për montim barrierash, eskavator me goma dhe 2 fadroma me goma, pasi kontrata e qerasë me subjektet BE-IS shpk, Arbnid shpk dhe SIRETA 2F nuk janë nënshkruar para noterit publik. Kjo është në kundërshtim në DT në të cilat kërkohet: [] *Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes /kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerase, faturat tatimore të shitjes / kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.* []

6. Skualifikohet operatori ekonomik “K-AAV” shpk, sepse nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DT dhe bazes ligjore në fuqi të aplikueshme sipas rregullave të prokurimit dhe LPP. Konkretisht, operatori ekonomik “K-AAV” shpk:

1-Nuk plotëson pikat e licences sipas kërkesës së DST në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave.

2-Mungojnë 2 eskavatore me goma

3-Mungojnë 2 fadroma me goma

4-Mungon Automjet vijezimi me boje bikomponente

5-Mungon freza gerryese me gjeresi 2 m

6-Mungon Trencher per hapje kanali

7- Nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme, sipas kerkeses se DST në pikën 2.3.1, të kriterëve të veçanta, shtojca 12 e dokumentave.

8- Nuk plotëson kriterin për numrin mesatar të punonjësve

9- Nuk plotëson kriterin për xhiron mesatare të realizuar në tre vitet e fundit,

etj

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**AL-ASFALT**” sh.p.k, me adrese: **Durres Xhafzotaj, Sallmone Rruga Hoxheve, Zona kadastrale 3852, Nr. pasurie 19/36** se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **121.508.153 (njqind e njezet e nje milion e peseqind e tete mije e njeqind e pesedhjetë e tre) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, Adresa: Rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 2234789 / +355 4 2223600, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës (nëse është kërkuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.04.2021

Ankesa : Ka patur ankesa dhe operatorit ekonomik i eshte kthyer pergjigje me date 10.05.2021.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys VERDHO